

EMIR IMAMOVIĆ PIRKE

Përktheu nga origjinali Ben Andoni

E FSHEHTA E LUGINËS SË PIRAMIDAVE

*(Në gjurmë të dëshmive
se në Bosnjë dhe Hercegovinë jetonin qenie inteligjente)*

Dita e BL MEDhP

Dita ishte me diell, gjë që në korrik nuk përbën ndonjë çudi. Terreni, ai, i vetmi i vijëzuar me shenjat e autit dhe me dy pika të bardha, ishte ideal për lojë në territorin e Bashkësisë Lokale Mëhalla e Poshtme dhe e Epërme. Nga ana lindore, mbi stolat e bardhë plastike rrinin të ulur dhjetë etër krenarë. Nëntë mama qëndronin pas kurrizit të tyre, duke iu bindur porosisë së prerë, që të mos llomotitnin dhe nëse do guxonte të çuquriste qoftë dhe njëra prej tyre, atëherë të gjitha do të shkonin në pidh të s'ëmës, siç ua sqaroi me një frymë Sejo Urgjenca, babai i sulmuesit me perspektivë së të Bardhëve, Edin Dino Llostiq. Ndeshja filloi tamam në mesditë, nën një tridhjetë e pesë gradë Celsius aspak të këndshëm.

As gjurmët e shkruara të së shkuarës, e as kujtesa kolektive nuk japin përgjigje për pyetjen se kush, kur dhe përse u vendos që çdo të shtunë të dytë në muajin e shtatë të kremtohej dita e bashkimit të Mëhallës së Epërme dhe të Poshtme në një njësi administrative të vetme të komunës së Visokos. Më e vërteta besohej se Dita e BL MEDhP, siç quhej festa në shkresat zyrtare, e mori kuptimin nga Muhamet Trampo Bugjoni, heroi popullor dhe polici i pensionuar sak në kulmin e fuqisë.

Rrëfejnë po ashtu, se gjithçka e sajoi Ostoja Nikoliq, ish-kryetari i Mëhallës së Poshtme, për t'iu lajkatur më të rëndësishmit mëhallepërm në histori, personalisht Bugjonit dhe se Dita e BL MEDhP, në të vërtetë, përkonte edhe me ditëlindjen e Tramos, e ajo që për çdo vit bie në një datë tjetër, nuk është tepër e rëndësishme: dikur fëmijët lindnin nëpër fusha, ndërsa regjistroheshin në zyrat e gjendjes civile, kur babai gjente kohë të shkonte deri në çarshi për duhan, sapun, kafe dhe pastaj t'i regjistronte vogëlushin shtetit.

Askush, pra, nuk e dinte se kush ia dha kuptimin dy udhëve të pjerrëta, fundet e të cilave bashkoheshin rreth xhamisë, por që, fillimisht si legjendë, pastaj si një shaka, nga gjenerata në gjeneratë, u tregua sesi plaku Salih Trampo e regjistroi të birin dhe për këtë mori edhe një vit burg. Në fillim e mbajtën sekret, ndërsa më vonë e theksonin që para se të shkonte te ofiqari Salih kishte pirë pak raki të nxehtë, dhe i ardhur çakërrqejf, i tha nëpunësit të mbretërisë: "Ja, erdha të regjistroj fëmijën që mbreti paskëtaj të ketë se kujt t'ia pijë gjakun."

Salihu s'pati mbërritur ende në gjysmë të rrugës për në shtëpi, kur e lidhën xhandarët dhe e përcollën në burg për shkak të fyerjes së Lartmadhërisë së Tij.

Sidoqoftë, Dita e Lokales, kështu si e quante bota për t'mos prishur zakonin, kremtohej prej vitesh. Festat e çuditshme kanë zakone të ndryshme: në disa vallëzohet nëpër stadiume, në disa theret bagëtia apo kërcëhet drejt lumit të akullit, e në disa... Çdo të shtunë të dytë në muajin e shtatë, dy koret e fëmijëve, të krijuara prej ndarjes së njërit nga shoqëria kulturore-artistike "Ivo Lllolla Ribar", nisëshin respektivisht nga dy mëhallët, duke kënduar të njëjtën këngë. Takoheshin në xhami, të bashkuar nën vargjet *Dhe në majën e malit, flamuri valëvitet, i kuq nga gjaku i proletarëve*. Që nga Dita e parë, problemi do të mbetej me gjatësitë e rrugëve. Pasi Mëhalla e Epërme ishte plot njëzetë metra më e gjatë se e Poshtma, mëhallepërmit do të nguteshin në ecje dhe këndonin, saqë pjesa e fundit e këngës dilte plot psherëtima dhe kollitje të këngëtarëve të rraskapitur, të cilave nuk mund t'ia mbyste zhurmën as britma e korit nga e Poshtma.

Dita e filluar me këngë mbaronte me zjarr. Te flamuri i këndit në stadiumin më të mirë të rrethit rrotulloheshin në hell qengjat, në qendër tymonte skara, ndërsa në përrua, i cili çdo

vit merrte nga një top, ulej temperatura e birrës. Fëmijët, të rraskapitur nga zhegu dhe kërcimi i tërë ditës, mezi prisnin të merrnin nga pesë qebapë me gjysmë somune dhe pastaj të ktheheshin në shtëpi, ndërsa gratë, prapëseprapë, duhej të prisnin të ushqenin fëmijët, kurse burrat prisnin që gratë e fëmijët të largoheshin, e pastaj të pinin pa vështrimet e murrëtyera të shoqëruesve të jetës dhe pa zhurmën që pas çdo pije të re gjithnjë e më shumë të shkon në nerva. Pastaj do të grumbulloheshin, mes pesë zjarreve, të gjithë më të vjetrit se pesë vjeç dhe më të rinjtë se shtatëdhjetë e pesë vjeç dhe për askënd nuk kishte më rëndësi se çfarë festohej.

Ngjarja kryesore e kremtimit ishte ndeshja e mesditës e dymbëdhjetëvjeçarëve. Për shkak të dyshimit të arsyetuar se Bugjoni kishte lindur bash në dymbëdhjetë korrik, të drejtën e pjesëmarrjes, sipas rregullave të pranuar të festimit, nuk kishin as ata që deri në ditëlindjen e trembëdhjetë numëronin më pak se një ditë, as ata që vetëm një ditë më parë festonin tamam trembëdhjetë. Për mrekulli, askujt s'i kishte rënë ndërmend të ndryshonte rregullin, por ndodhte që ndonjëherë të luanin tre kundër tre, ose që për Mëhallën e Poshtme merrnin pjesë edhe deri në shtatë dymbëdhjetëvjeçarë, kurse në të Epërmen, ku lindnin kryesisht vajza, ishin vetëm katër çuna, nga të cilët njëri e kishte një këmbë më të shkurtër apo vuante nga bronkiti alergjik, e që në dy pjesët e lojës dëgjohej shpesh tek dihaste duke dëgjuar se si dikush i çirrej: "Imja, imja... me thembër... faull, arbitër... për atë babë...!"

Në korrikun e njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e treshit, e Epërmja shpresonte më në fund në fitore pas një serie humbjesh të rënda. Kishin njësoj si kundërshtarët, plot shtatë dymbëdhjetëvjeçarë. Dy prej tyreve, sikurse edhe te kundërshtarët, baballarët u punonin në ndërtim në Podgorë, ndaj edhe në tribunë ishin njësoj. Dhe ajo që ishte më e rëndësishmja, Edin Dino Llostiq tashmë ishte i grumbulluar në klubin lokal, por të vërtetë futbollit, gjë që nuk kishte ndodhur me të dy mëhallët, që nga fëmijëria e Suad Mashiqit, mjeshtëria e të cilit kish bërë që KF Zhelezniçar ta shpërblejë me një kontratë katërvjeçare dhe me një Golf të ri.

Mëhalla e Poshtme luante me bluza të bardha, ndërsa e Epërmja me të kaltra. Vetëm portierët kishin bluza të verdha: Amer Trampo tek e Poshtnja dhe Elvis Muharemagiq në të Epërmen. Arbitri, një amator, dhe që s'ishte asgjë më shumë sesa korrespondenti i disa gazetave lokale, Jozo Martinoviq, topin e parë ua la të bardhëve dhe i fryu bilbilit tamam në drekë, ndërsa djersa ia kishte lagur krejt bluzën me imazhet e stampuar të Marianës dhe Sandokanit.

Ajo ishte, ashtu si thuhet tashmë, një ndeshje e fortë dhe përplasje e dy shkollave të futbollit. Trajneri i të kaltërve, vëllai më i madh i Edinit, Nihadi apo Nino, siç e thërrisnin, insistonte në të ashtuquajturën lojë valëvitëse me pasime të shkurtra në mesfushë, si dhe me diagonale të gjata që përfundonin në sulm, të cilat vëllai i tij duhet t'i shndërronte në gola. Inxhinieri i minierave nga Breza, që për këtë rast angazhoi kolegun e specializuar për gjeologji dhe babai i portierit së të bardhëve, megjithatë, e vlerësoi mirë kundërshtarin. Dy më të shëndoshët, dy djem jo shumë të zhdërvjellët, por të butë si vinçat pirun, me zgjuarsin ruanin Dinon, ndërsa të tjerët vraponin si të kurdisur nga mbrojtja në sulm dhe anasjelltas, ndërsa të kaltrit më kot po përpiqeshin të mos humbin topin, e Amer Tramos më para mund t'i binte dielli në kokë sesa të pësonte gol.

Për plot pesëmbëdhjetë minuta baballarët rrinin ulur të qetë, duronin vapën dhe soditnin ndeshjen, duke i ndezur cigaret njërën pas tjetrës. Sead Sejo Llostiq u bë i pari me nerva

dhe i tha të birit, Ninos, me zë të lartë se çfarë mendonte për aftësitë e tij të trajnerit: “Nino, o bir, ti ose je gjeni i vërtetë, kështu që askush nuk të kupton, ose je komplet budalla! A e shikon që askush nuk...”

Sejo Urgjenca deshi të thoshte se ekipi i kaltër nuk mund të kishte shans edhe sikur të tërë ekipin e të bardhëve ta kosiste ndonjë sëmundje, kur Dino disi u lirua nga rojtari dhe me gjithë fuqinë goditi topin e ri, të bardhë, që për Ditën e Bashkësisë Lokale e kishte dërguar Suadi, pa harruar që në pusullën me shkrimin e tij të shtrembët dhe me analfabetizmin e shkëlqyeshëm të shtonte se “*me t’illë stërvit Zhelo, po’ ekifi parë*”. Qëkur topi u ngrit, ishte qartë se po shkonte pak më poshtë vendit ku bashkohen shtylla e traversa dhe, nëse nuk ndodhte çudia, të kaltërtit do të udhëhiqnin.

Nga shtatë korriku, Maria Trampo më kot ishte zëri i arsyes. Dalmatinaşja, të cilën dashuria nga Visi, prej një aksioni pune në rrethinën e Mostarit, e solli drejt Visokos, po shihte sesi biri i saj, një ditë pasi mbushi dymbëdhjetë vjeç, hidhej si një i çmendur në divane e krevate dhe teksa do binte, thërriste me gjithë zërin: “Ndërhyrje e shkëlqyeshme e të riut Trampo!”

E ndërsa e prisnin sustat e mbuluara me jastëkët e sfungjertë, do të shtonte: “Me portierë të tillë, e ardhmja e futbollit tonë është e pa kërcënueshme”.

“Do ta shikosh ti, kur të vijë tati”, e ngriti ajo zërin pas disa orvatjeve të pasuksesshme, që në gjuhën që ende s’e kishte harruar as pas viteve të Bosnjës, t’ia sqaronte të birit sesi “nuk do ta shikonte më as detin, as gjyshen, nëse paratë do të duheshin për një shtrat të ri”. Ameri për pak kafshoi gjuhën duke u orvatur t’i shpjegonte asaj që nuk brengosej, teksa u hodh për të mbrojtur shutin e përfytyruar nën traversë. Marisë i mbetën aq nerva që ta priste nga puna të shoqin, Safetin, ta linte që të pinte një raki të vogël e të hante supën dhe pastaj t’i thoshte: “Të lutem, thuaji që mos të na i thyej divanet. Nuk do kemi më ku të shtriqemi. Mua s’më bindet më”.

Inxhinieri i gjeologjisë Safet Trampo i urrente detyrat që i caktonin pasi vinte në shtëpi, por menjëherë hiqte kostumin, i lante vetë çorapet dhe i vendoste që të thaheshin në skaj të vaskës, vishte atletet dhe pushonte duke u ulur për të drekuar. U kthye nga i biri, bashkoi vetullat dhe duke mos e ngritur tonin i tha atij, ndërsa mjekra i dridhej pak: “A do tani të ta flakëroj një shpullë sa të harrosh emrin, mbiemrin dhe deri numrin personal të identifikimit qytetar?”

“Duhet të stërvitem, do të mbroj portën për Ditën e Lokales”, iu përgjigj Ameri dhe kaloi me një gllënjë të vetme dhe pak supë.

Të nesërmen Safet Trampo erdhi në shtëpi me një top hendbolli dhe në vend që të flinte pasdite si zakonisht, stërviti Amerin: pas pesëmbëdhjetë ditësh të tjera shkatërruan divanin e Lesninës dhe shtretërit e Shipadit, të gjashtëmbëdhjetën provuan në qilim dhe nga një korriku u stërvitën në tokë. Maria e mbajti veten, sepse: as burri dhe as i biri nuk e dëgjuan. E bija tashmë ishte tek nëna e saj në ishullin Vis.

Çdo sustë e thyer dhe çdo blanë e shkaktuar nga rënia në qilim apo nëpër oborr u shpague në atë moment, kur Edin Dino Llostiq dërgoi goditjen që shpesh përshkruhet si e drejtë. Sejo Urgjenca kërceu, Nino ishte gati të bërtiste nga gëzimi, tifozët e të kaltërve rrëzuan stolat teksa ngriheshin... dhe pak, vetëm pak mungonte deri te çasti i gëzimit. Ameri u përdrodh, rrafshoi trupin me shtyllën e portën e përshtatur me madhësinë e lojtarëve dhe me pëllëmbën e majtë e kaloi topin në kornier. U dëgjua vetëm një e thellë: “Ua, të qiftë akulli”. Pjesa e parë u mbyll me rezultatin më të padëshiruar: zero me zero.

Nino u ndau lojtarëve të tij të lodhur, të nervozuar dhe të dëshpëruar dy shishe të ngrohta Kenijada dhe e gjitha ajo që kishte për t'u thënë ishte: "Hajt, ngopuni."

Inxhinieri nga Breza e përgëzoi secilin dymbëdhjetëvjeçar me të bardhë dhe sapo u ulën në tokë, nisi t'u sqaronte diçka gjallërisht, duke vizatuar me majën e lapsit vija në pluhur. Të kaltrit ishin ulur dhe po shfrynin, derisa Sejo nuk zbriti por me një të shkurtë tha: "marsh në shtëpi, të mos të shikoj më" dhe e ndërroi trajnerin.

Për dy minuta u sqaroi që të tërhiqeshin pak, që sulmin ta ndërtonin më gjatë dhe që dikush duhej të zëvendësonte Dinon duke vrapuar bosh, për t'i lodhur dy mbrojtësit. Ndërsa ata ngriheshin të plogësht të vazhdonin lojën, ai shtoi se të gjithëve do t'ua qinte tezet nëse nuk fitonin, që nuk ishte ndonjë kërcënim serioz, duke pasur parasysh që në urgjencën e Sejos, pa pasur parasysh gjithë luksin e gënjeshtreve të tij, në vend të grave të pamartuara apo të pabesa, ishin shtrirë vetëm pacientë.

As minutat e para, siç shkroi Jozo Martinović në raport, të cilin nuk e botoi shtojca e sportit në *Oslobogjenje*, nuk sollën lojë të pasur dhe të bukur për tu parë. Megjithatë, të kaltrit kishin epërsi të lehtë, gjë që i detyroi të bardhët të bënin gabimin kapital – në vend që të vraponin pas lojtarëve, filluan të vraponin pas topit. Pas një topi të tillë, të nxitur nga asgjëja dhe duke i injoruar udhëzimet nga bankina, u nisën mbrojtësit e Dinos nga pjesa e parë. Të lodhur, të nxehur dhe të rëndë, mbetën duke gulçuar, derisa topin në mënyrë të pakontrolluar e goditi me këmbë portieri i të kaltërve. Elvizi, këmbët e të cilit shërbenin për të kërcyer ndërsa këndonte në emisionin *Tobogani muzikor*, e përcolli topin në fushën kundërshtare, pikërisht në mes të Amerit dhe Dinos. Të dy u nisën në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin drejtim, duke parë pak nga qielli dhe pak para vetes. Dino ngriti këmbën, ndërsa këmba e djathtë e Amerit qëndroi mbi lidhësen e zgjidhur të atletes së majtë, duke u rrëzuar kah kushëriri i parë, më saktë djali i hallës së tij. Ameri nuk e ndjeu që topi e goditi në prapnicë dhe as nuk e dëgjoi sesi të kaltrit gëzonin kur topi u rrokullis në gol. Tamam atëherë, Dino e goditi me gju në majën e mjekrës dhe, madje dhimbjen e zëvendësoi terri dhe diçka e nxehtë në gojë.

Ndeshja nuk vazhdoi. Safeti mbante Amerin, të cilit i rridhte gjak nga goja, Maria vraponte pas tij, duke bërë kryq dhe i lutej Virgjëreshës Mari dhe Antonit së Shenjtë, ndërsa Sejo shpejt vendosi me forcë çelësin në makinën e ndihmës të shpejtë mjekësore, duke ngushëlluar prindërit e çmendur të Amerit: "Ja pse e parkoj urgjencën në avlli. Tash do të shkojmë në ambulancë për një sekondë. E gjitha do bëhet mirë..."

Dino, me gjurin e mbledhur, duke u mbështetur te bashkëlojtarët, eci pupthi deri në shtëpi. E ëma ia lidhi këmbën me një fashë të ftohtë dhe atë pastaj e zuri gjumi. Ëndërroi që Ameri nuk ra dhe ai i pari arriti tek topi, e me një goditje të lehtë, ia kaloi topin poshtë këmbëve kushëririt, drejt fitores së Mëhallës së Epërme, të parës në kushedi sa vitet e fundit.

Për të gjitha është fajtor Dejvid Beckham

“Në qytetin tonë, rajonin, shtetin, në Ballkan dhe natyrisht në të gjithë Evropën, nuk ekzistojnë piramida, të cilat të jenë të ndërtuara nga popuj të lashtë, që për ne janë pak apo aspak të njohur”, lexoi Amer Trampo nga letra, pastaj ngriti kokën dhe vështroi gazetarët e mbledhur në konferencën e shtypit: një mbajtës kamere, lëvizjet e pakontrolluara të së cilit flisnin që ose do kishte gëlltitur *ecstasy* ose bënte pjesë tek ata që kanë sindromën e misionarëve dhe orvaten të sqaronin si dëshirë që, më në fund, të bëhej revolucion në shprehjen e medias, dhe Jozo Martinovićin, që ndërkohë kishte fituar llagapin e Gjuhëtarit dhe akreditimin e tij në një tabloid ditor me tirazh të mirë, politika botuese e të cilit ishte: nëse faktet nuk na përshtaten, atëherë aq më keq për faktet. Elvis Muharemagiq, në vend që të fotografonte, fliste me Dinon, vetëm dhjetë metra pas kurrizit të fuqisë së shtatë në formën e reduktuar. Nga radioja lokale nuk erdhi askush.

Ameri kapërdiu pështymën, preku ballin, ndreqi pak kapelën dhe vazhdoi: ”Që të jem i saktë deri në fund, nuk ekzistonin deri më sot. Ju kumtoj me krenari, urbi et orbi, që këtu në Visoko, praktikisht pas kurrizit tim, ndodhet një piramidë e gurtë me përmasa të papara, ndërtues të së cilës janë paraardhësit tanë të lashtë.”

Kameramani në këtë moment iu afrua Amerit, duke ia vendosur objektivin deri në majë të hundës dhe shpejt e lëvizi drejt majës të Visočicës, malit ku dikur ishte kështjella e gurit, e disa shekuj më vonë do qëndronte mbishkrimi i madh, i gurtë TITO. Jozo vetëm sa u kollit.

Dino dhe Elvisi po flisnin pikërisht për rolin e Aleks Fergusonit në jetët e tyre, kur iu afrua Ameri, i përqafoi dhe sikur t’i ftonte për sillë, u kumtoi: ”Zotërinj, ju thërras në vizitën e parë zyrtare të Piramidës boshnjake të Diellit”.

“Ku, jaran?”, e pyeti Elvisi.

Amer u tregoi me gisht malin, mbi të cilin sapo ishin ulur re të rënda ngarkuar me shi.

”Shiko, bukurosh, e sheh.”

“Amer, byrazer, është baltë”, iu kthye Dino, ndërsa Ameri dhe Elvisi u nisën. Bënë sikur nuk e dëgjuan.

Pështyu anash, shikoi atletet e reja një numër më i madh, dhe u nis. Një copë balte e lëndinës pa bar, në qoshkun e së cilës mund të shihej ende ndonjë copë ashkël e djegur dhe ku për gjithë vitin nuk shuheshin vijat e autit të shënjuara me gëlqere, e qetësoi pak minuta më vonë.

Dino përnjëherë shpejtoi hapin. Besoi që po të ndotej mirë, madje, nëse do të duhej dhe t’i prishte atletet e reja, do ta ndërpriste vijën disaditëshe, thënë butë, të ngjarjeve të çuditshme që kishin sjellë shqetësimet aspak të dëshiruara në jetën e tij të zakonshme, sa të mërzitshme dhe po aq të ngadaltë. Në një moment, madje, e arriti edhe Amerin, por iu kujtua se dikush mund të mendonte se ai është fajtor që po ngjiteshin shpatit të rrëshqitshëm. Si zakonisht, nuk brengosej për mendimet e huaja, por trembej nëse dikush do e pyeste se për çfarë dreqin po ngjiteshin dhe përlyheshin dhe ai nuk do dinte si t’i përgjigjej. E nga ana tjetër, as ai vetes nuk po arrinte t’ia sqaronte, përse nuk kthehej dhe të shkonte tek *Offside* në kafe dhe të shikonte rezultatet e ndeshjeve të NBA-së në teletekst.

Ajo që Dino dëshironte të ndërpriste, sikur edhe të mbetej zbathur, filloi pesë-gjashtë ditë më parë, gjegjësisht nga ajo se a matet koha nga momenti i pagesës në bastore apo nga fundi i ndeshjes që e pa në xhirimin e vazhduar, kur nëntëdhjetë minutat mbaruan pak pas mesnatës. Deri në pjesën e dytë të ndeshjes i mungonte një gol i vetëm për fatin, i cili mund të shprehej me numra: dhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë marka ishte fitimi në skedinën që e kishte paguar rreth mesditës duke depozituar dhjetë marka. Dhe të gjitha i gjeti: gjashtë ndeshje në fiks dhe shtatë në variabla. Parma, për befasinë e përgjithshme të tifozëve të vet, u ngrit dhe fitoi si mysafire.

Reali i Madridit priste Malagën. *Galaktikët* në njërën anë, ndërsa në anën tjetër ishte ekipi, të cilin – si shumë e shumë të tjerë, që për pak sa nuk e mundi Zhelo. Forcat kozmike, mungesa e motivit dhe e gjithë fatkeqësia sportive ishin atë natë kundër Edin Dino Llostiqit. Në tërë pjesën e parë lojtarët e Realit orvateshin të thyenin shtyllat. Van Nistelroy, Raul, Beckham, Figo dhe ai Kambiaso goditnin vetëm kornizën e portës. Malaga nuk po dinte as sesi ecësh mbi barin e anës tjetër të Santiago Bernabeut. Mbeti zero me zero deri në minutën e gjashtëdhjetë. Deri në minutën e gjashtëdhjetëtrë Malaga kishte dy gola epërsi. Dy herë për dy minuta kaluan qendrën dhe dy herët vrapuan pas duke u gëzuar!

Dino u fundos në kolltuk. Frymëmarrja iu përshpejtua, lukthi iu mblodh dhe veshët i gumëzhinin sikur në vend të trurit të kishte në kokë një elektromotor. Ngadalë u drejtua, mori kutinë e cigareve nga tavolina, me cep të syrit këqyri numrin e fatit dhe zhubrosi kutinë e Drinës. Ishte, siç ndodh gjithmonë pikërisht kur njeriut i duhet qetësimi me nikotinë, e zbrazët. Shkoi për të marrë një tjetër. Ndërsa mori duhanin nga sirtari, përfytyroi sa mirë do ishte po qe se para televizorit do ta priste zëri i ngjirur i komentatorit euforik: “Çfarë kthese, të nderuar shikues. Ja pse Reali është Real”. Nuk guxonte t’ia ngrinte zërin, që të mos zgjonte të ëmën.

Priti një penallti për Malagën! U ul në kolltuk, ndezi cigaren dhe zhubrosi skedinën e bastores. Deshi ta digjte, por iu kujtua se Sena nuk reagonte vetëm ndaj zhurmës por edhe ndaj erës së keqe. Arbitri dha shenjë, topi u nis kah goli dhe... Kasiljas u zgjat dhe me shuplakën e majtë e përcolli në kornier.

“Karit i qofshim falë, o Iker”, tha Dino.

Fati është si lavjerrësi: nuk mund të shkojë gjithmonë në të njëjtin drejtim. Reali barazoi në minutën tetëdhjetënjë. Në tetëdhjetëtetën ishte baras. Dino, si të ishte në ekstazën e fanatikut fetar, shikoi nga tavani: “Zoti e ruan Dinon e tij!”

Me kujdes e shpalosi topin prej letre dhe me shuplakën e dorës e drejtoi pak. Deri te dhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë markat i duhej sërish një gol dhe vazhdimi zemërgjerë i arbitrit. Pesë minuta, së paku.

“Ashtu qoftë, mjeshtër”, pëshpëriti Edin duke u lëshuar në gjunjë.

Arbitri i pamëshirë akordoi një penallti për Realin e Madridit. Ishte minuta e nëntëdhjetë e tretë. Dejvid Beckham rregulloi topin, vështrroi portierin, bëri katër hapa pas dhe mori frymë më thellë se sa Dino në Visoko. Dinos sikur i pëshpëriti dikush: “Do të dali huq”.

Tundi kokën majtas dhe djathtas, që t’i largonte parandjenjat e këqija dhe iu afrua edhe më shumë televizorit.

“O, të qifsha Viktorian me ato kockat e saj anoreksive”, shau Dino nga dysHEMEJA, ndërsa Beckham mbante kokën duke shikuar lart sipër portës, aty ku pak më herët i dha shkelmin edhe dhjetëmijë e treqind e gjashtëdhjetë markave të Edin Llostiqit.

Është e vështirë, që në bazë të shikimit në arkivin e gazetave të sportit në Spanjë, të gjendet se si fjetën atë natë Viktoria dhe Dejvid Beckham. Por Dino nuk mbylli sytë deri në agim. Shikoi përsëritjet e një seriali forenzik. Pastaj ndoqi zgjidhjen e vrasjes së striptistes në Las Vegas, policit – që përdorte kokainë në Nju Jork dhe piktores ukrainase në Majemi, që ishte e prekur me HIV pozitiv. Pastaj në krevat lexoi librin “*Si e shpjegon futbolla botën*”, duke kërkuar përgjigjen në pyetjen, pse Reali nuk fiton kur atij i duhen para. Nuk e gjeti. Cigaren e fundit e piu në katër e gjysmë, duke u ngushëlluar se të paktën ishte mirë që s’kishte punë, kështu që së paku mund të flinte sa të donte.

Sena Llostiq e përshkoi me mundim rrugën nga krevati deri në banjë, pastaj nga banja deri në dhomën e Dinos. Këmba e saj e majtë, pak më e shkurtër, me dëshpërim kërkonte shiun. Filloi t’i dhembte dy ditë para se lajmet e radios në parashikimin e motit të lajmëronin se si vala e ajrit të ftohtë nga veriu do të sillte reshje në fillim të javës së ardhshme. Java, megjithatë, filloi, por shiu nuk kishte rënë ende. Dhimbjet po e lodhnin Senën. I duhej një rrebesh që të merrte frymë. Hapi derën e dhomës së Dinos, u vrenjt kur pa se si i biri i saj flinte afër tavllës së stërmbushur të duhanit dhe e thirri, duke u mbështetur në kornizën e derës: “Dino, Dino! Ngrehu, bir...”

Dino nga e djathta u rrotullua në anën e majtë dhe tërhoqi jorganin deri te veshët. Sena shtrëngoi dhëmbët dhe ngadalë u nis drejt krevatit.

Nënat deri në vdekje mbajnë mend se çfarë duan fëmijët e tyre për të ngrënë, kur e kanë kohën për të fjetur dhe si mund të zgjohen më lehtë. Sena u ul në cep të krevatit dhe me gishtin tregues e përkëdheli nga veshët Dinon.

“Mmmmmmm”, mërmëriti Edini pa i hapur sytë.

“Ngrehu bir”, i pëshpëriti Sena.

Tridhjetë e pesëvjeçari ëndërrimtar me dembeli u kthye në shpinë.

“Sa ka vajtur?”

“Tetë, dhe e ka kaluar pak.”

“Lëre tani, mama, bëhu pak serioze.”

Dino u kthye anash.

“Duhet të shkosh të marrësh Amerin në aeroport. Tani po të përgatis kafënë.”

Senës secila lëvizje po ia therte trupin: që nga këmba e thyer dhe deri në majë të kokës. U largua ngadalë nga dhoma, sikur qilimi të ishte i minuar.

“Cilin Amer, pash Titon?” Dino u shtriq sërish në kurriz.

Sena iu përgjig pa u kthyer: “Amerin tonë. I dajë Safetit dhe teze Marisë. Si, cilin? Sot vjen nga Amerika”.

Kur u ndodh drejtpërdrejt një ngjarje, gjë që në Bosnjë tashmë nuk është edhe aq rrallë, njerëzit me vështirësi se befasohen më. Kur Sena e përmendi Amerin, Dino u ndje sikur ajo ta kishte lajmëruar që ishte zgjedhur ministre e mbrojtjes.

“Prej nga ai...?”

Sena u ndal, ktheu kokën dhe tha: “Ja kështu... erdhi”.

“Dëgjo?!”

“Po.”

“Tito të qiftë”.

“Mos leh, Dino”.

* * *

Ajo gjithë jetën kish pirë kafe nga filxhanë të mëdhenj, ata prej dy decilitrash, që për gratë e moshës së saj në Bosnjë nuk është edhe e zakonshme. Sena i kishte mjaft dhimbjet e saj dhe nuk donte që edhe gishtat t’i digjeshin në buzët e filxhanit, i cili mbante aq kafe sa porcelani i nxehtë të shkaktonte djegie të shkallës së dytë. Atë mëngjes, ajo zgjodhi atë me stemën e Hajdukut të Splitit, dhuratë e Marisë për ditëlindjen e saj të shtatëdhjetë. Dino, kafën e tij, nëse ashtu mund të quhej një decilitër qumësht dhe një pikë lëngu i zi, e pinte nga filxhani, në të cilin shkruante BH FANATICOS. Dy cigaret e para i piu në qetësi. Në gjysmën e së tretës e pyeti të ëmën se kur mbërrinte avioni i Amerit.

“Sot”, iu përgjigj qetë Sena.

Që duhet të ishte më e qartë, e kuptoi nga shikimi i të birit. “Mendoj, nga ora dy-tre pasdite.”

Piu pak kafe dhe zgjati dorën nga i biri. Ishte kjo shenja që ai t’i zgjaste cigaren e tij. Sena nuk guxonte të tymoste, por kishte dëshirë. Pinte deri pesë cigare në mëngjes dhe nuk e fshihte kurrë që ua kishte zili duhanxhinjve.

“Jam ndalur pak, që të mos vdes. Sikur ta dija se do më mungonte kaq shumë, do të pija dyfish. Sapo të martohet Dino, unë do ta vazhdoj, qoftë edhe nëse ngordh”, thoshte kur dikush i fliste se sa mirë ishte që nuk pinte duhan.

“Mirë, mam’, pse më zgjove?”, pyeti Dino, ndërsa plaka po e thithte tymin deri në fund të mushkërive.

“Që të mos vonohesh”, iu përgjigj atij duke e nxjerrë frymën.

“Mirë, por... kam njëzetë kilometra deri në aeroport... Nuk do të shkoj në këmbë...” Dino do të kthehej në krevat në atë moment po të mos ishte nga ata, që kur zgjohen njëherë, nuk mund të flenë më pa përdorur sedativ.

“Po mirë, bir.”

Sena e shoi cigaren. Dino ndezi një të re. Pesë minuta nuk folën.

“Mundesh, për atë Zot, edhe të rruhesh.”

“Nuk dua.”

Lufta e bimëve dhe kohëve

Caffé Offside funksiononte jashtë logjikës ekonomike. Kishte pak klientë të përhershëm, jeta e të cilëve vazhdonte ndërmjet fazave të gjata pa para dhe krahas kësaj ishte në vendin më të shëmtuar, dhe as interieri s'ishte më i mirë. Porsa punësohej kamerieri i ri, do e merrte për së paku gjashtë muaj lokalin me qira, deri sa nuk i mërzhitej të punonte dhe nuk e zbulonte se si për një vit të tërë mbahej me fjalë ngushëlluese, thjesht zero pozitive. Kamerierët, në të vërtetë, vinin zakonisht nga grupi i vogël i vizitorëve të përhershëm. Në distanca të rregullta kohore, dikush do të kuptonte se, derisa rrinte aty tërë ditën, mund të provonte edhe të nxirrte ndonjë fitim. Vetëm Dino nuk u dha. Ka dhjetë vjet që kur ekziston *Offside* dhe ai e viziton për çdo ditë, përveç të dielës –ndaj u mësua shumë me kundërmimin e murit të mykur të ndërtesës prej betoni, ku duhej të ishte qendra tregtare-afariste Razvitak. Edhe pse u harxhuan tonelata me çimento, por asnjë shenjë e Razvitakut. Gjithsej tri hapësira të aftësuara, nga pesëdhjetë hapësira biznesi të planifikuara, shërbenin për *caffé*, bastoren *Overtime* dhe *fast food grill*, sanduiçët e të cilës e furnizonin rregullisht Shtëpinë e Shëndetit të Visokos me të sëmurët nga salmonela.

Dino, i saporruar, hyri aty rreth orës nëntë e gjysmë. Zhuti, pronari më i ri, lexonte gazetën i mbështetur në banak; Jozo Gjuhëtari po qetësonte duart me një liker të hidhët dhe përpiquej të shkruante një porosi me SMS, duke ndarë tavolinën me Elvis Muharemagiqin, i cili po shikohej në xham duke ushtruar mënyrën më të mirë të nxjerrjes së tymit të duhanit.

“Tungjatjeta, vogëlush”, - përshëndeti Dino.

“Tungjatjeta, të gjithëve”, ia ktheu përshëndetjen Jozo.

Elvisi nuk mund të thoshte asnjë fjalë. U orvat ta nxirrte tymin nga goja te hundët dhe filloi të kollitej aq sa Gjuhëtarit i pështyu drejt e në ekranin e celularit. Zhuti e ndërpreu leximin dhe u nis të përgatisë një *espresso* për Dinon: dopio, të shkurtër me shumë qumësht dhe me pak sheqer. Dino u ul dhe vështroi televizorin, në të cilin ishte teleteksti me rezultatet e ndeshjeve të NBA-së.

“Ky Dallasi e shkatërroi San Antonion... Ia qifsha nënën, ai Reali si ma nguli...”, komentoi.

“Eja”. Zhuti u fut në bisedë duke sjellë kafënë.

Në *Offside* flitej kryesisht për sportin, mbi të gjitha për futbollin, por nga këndi i humbësve të bastoreve. Të gjithë kishin mendim të përbashkët për tri gjëra: që *Seria A* ishte e trukuar, që Dejvid Beckham kishte qenë lojtar vetëm te *Mançesteri* derisa stërvitej nga Aleks Fergusonit dhe që hokeji çek është më i miri për të fiksuar rezultate, sepse në pjesën e parë të ndeshjes asnjëherë nuk ka shumë gola. Nuk është evidentuar që dikush kishte kthyer depozitimet në Spartë dhe Teplice, por ashtu si po thoshte Zhuti, shpresa vdes e fundit, ndërsa Nada Obriq e parafundit.

Në *Offside* nuk bëhen kurrë thashetheme. Nuk do të thotë kjo se aty respektohej njëmend kufiri i intimitetit. Të gjithë aty i dinin të gjitha për të gjithë. Deri tek fshehtësitë e huaja vihej rreth e rrotull, fillimisht me ndonjë lajm kalimthi, pastaj me pyetje banale dhe bisedat mbaronin duke u rrëfyer.

“Të kam parë dajën dje”, tha Jozo, pasi e nisi porosinë me SMS dhe e fshiu celularin nga pështyma e Elvisit.

“Cilin?”, pyeti Dino përmes tymit të cigares.

“Sa ke, pash Zotin? Safetin. Plakun e Amerit.”

“Aha.”

“Thotë se Ameri sot vjen.”

“E di.”

“A tha në dy apo në tre?” – edhe Elvisi u inkuadrua në bisedë.

“Në katër”, shtoi Zhuti.

Kësi muhabetesh dëgjoi mjaft Edin Llostiq. E dinte çfarë vinte në vazhdim dhe sesi shumë, pastaj duke treguar gjoja vetëm sa për të thënë diçka, zbërthenin jetën e tyre deri në fund, duke u rrëfyer të tjerëve dhe atë që s’guxonin t’ia thoshin vetes.

“Kush e di a do të ketë ndryshuar?” - pyeti Elvisi, sikur po fliste me vete.

“Po, dreqin, edhe guri ndryshon pas nëntëmbëdhjetë vjetësh dhe jo njeriu i gjallë”, iu përgjigj Zhuti.

“Po, po. Madje në Amerikë... Nuk është pak aq kohë”, vazhdoi Jozo.

“Si i quhet e shoqja”, ishte Zhuti tani që bëri një pyetje të re.

“Xhejn”, iu përgjigj Dino dhe iu duk sikur i tha të gjitha ato që ata i dinin apo i parandjenin: se gjithë këto nëntëmbëdhjetë vjet nuk ishte dëgjuar me Amerin, se nuk i kërciste fort për gruan e tij, se që nga Dita e Lokales vetëm një herë ia kishin zgjatur dorën njëri-tjetrit dhe atë në xhenazen e Sead Sejo Llostiqit, dhe se jeta e tij sigurisht do të ishte ndryshe, nëse në vend të mjekrës së Amerit me gju do të kishte goditur topin.

Dino porositi edhe një kafe dhe heshti me kujdes.

“Nuk shqetësohem për të”, filloi të flasë sërish Jozo.

“Atij po i ecën ajo ndërmarrja”, ia priti Elvisi.

Dino mblodhi shpatullat.

“Kush e di a i ka rregulluar ata dhëmbë...?” Zhuti u orvat që të futej më thellë në temë.

Dino edhe më tej nuk përgjigjej.

“Ja qifsha t’ëmën, pse njeriu nuk ka tridhjetë e dy kara e një dhëmb”. Elvisi nuk e ndryshoi aq me zgjuarsin bisedën.

“Shkova unë për ofertën”, tha Dino dhe u ngrit nga tavolina.

“E kam unë”, i tha Zhuti me dëshpërim të lehtë.

“Lëre. Unë dua timen.”

Amer Trampo shkoi në Amerikë më 1989, ndërsa në Bosnjë zbriti në pranverën e hershme të vitit 2006. Të gjithë Trampot dhe Llostiqët rrëfenin për Borisin nga Stoca, që u martua me të voglën Alma nga Ilijashi, vajzën e kushëririt të gjyshit Muhamed, mandej hipi në anije në Plloçe dhe u hodh prej saj pak para se të mbërrinin Nju Jorkun, kështu që u fut në Shtetet e Bashkuara duke notuar. Ndërsa thureshin legendat familjare, Ameri gjeti Boron edhe Almën dhe programin e dhënies së bursave për talentet dhe mori vizën e pastaj bëri nënën dhe babanë me lot, duke u thënë se në Visoko vërtetë mund të bëhej vetëm burrë e baba, por kjo nuk përbënte ndonjë rezultat të rëndësishëm për të.

Avioni i *Austrian Airlines* arriti saktësisht në orën gjashtëmbëdhjetë në aeroportin e Sarajevës dhe tashmë pronari i firmës së transportit për mbartjen e mallrave delikate, Amer Trampo, vendosi kapelën në kokë dhe zgjidhi rripin. Në dalje u shfaq pesëmbëdhjetë minuta më vonë, duke shtyrë një karrocë të ngarkuar plot me valixhe dhe çanta. Dukej si Harrison Fordi pas kthimit nga xhirimi i vazhdimit të sagës për Indiana Xhons: Atlete të zeza deri në nyje të këmbës, pantallona ushtarake me ngjyrë të përhimët, një xhaketë e zezë e mbërthyer deri në grykë dhe kapelën me ngjyrë rëre.

Dinos, që prej operacionit, nuk i dhembte më gjuri. Ndjeu befas pak dhimbje, kur i mbështetur në banakun e kafeterisë së aeroportit pa Amerin. Dukej, pa llogaritur çantat, njësoj si në fotografinë që ia tregonte daja, kur i biri i tij iu kishte dërguar nga diku prej Andeve.

Ndërsa kushëriri nga Amerika, pa kurrfarë paniku, por me një shqetësim të lehtë po sillej, Dino mendoj se si, ndoshta, me kujdes mund të ikte nga banaku dhe të fshihej në WC... Vetëm se, përpara se të arrinte t'ia sqaronte vetes, se çfarë do të fitonte me këtë djallëzi të vogël, Ameri e përshëndeti me dorë dhe u nis drejt kafenesë. Dinos sërisht filloi t'i dhembte gjuri.

U përqaftuan dhe u puthën. Në të vërtetë, Dino e puthi Amerin. Ky, vetëm sa ka mbështetur një faqe, duke e prekur me pëllëmbë Dinon mbi supet.

“Ja, erdha edhe unë”, i tha Ameri duke e mbajtur Dinon prej shpatullash.

“E shikoj. A je për kafe?”

“Jo, të falënderoj, jam okej. E di, mami im ka sot ditëlindjen.”

“Ah, dreqin, në moshën e saj kjo nuk festohet, por shënohet.”

“Si mendon?”

“Nuk ka lidhje.”

“A ke ndonjë makinë?”

Dino gëlltiti pështymën, duke u përmbajtur që Amerit të mos i thoshte, që të merrte taksi dhe se ai kishte ardhur me autostop për ta marrë.

“Jo ndonjë, por një Pasat, pak si i vjetër. Vërtet nuk i kënaq standardet e Bashkimit Evropian, por punon si sahat.”

“Mrekulli”. Ameri më në fund i lëshoi shpatullat e Dinos dhe përplasi shuplakat. “Ai Bashkimi Evropian është gjithsesi një fazë kalimtare.”

“Mos more.”

“Natyrisht... Do të bisedojmë edhe për të. Kemi kohë.”

Pasati karavan i importuar në Visoko, kur shërbimi postar gjerman në vend që t'i hidhte në hekurishtet e vjetra ua kishte shitur boshnjakëve, për të cilët me rëndësi ishte vetëm të punonte, kishte një bagazh të madh. Për shumë vite, Dino aty linte gjithçka i duhej dhe gjithçka të lënë e harronte. Amer priti me durim që kushëriri i tij të mënjanonte kallamin e peshkimit, çizmet e peshkatarit, topin e shfryrë të futbollit, flamurin e Bosnje-Hercegovinës, dy shishe të zbrazëta uji mineral, roletat me letër higjienike me motive lulesh, batanijet dhe grilat e skarës. Dino me kujdes nxori vetëm kallamin, të gjitha të tjerat i shtyu nëpër cepa dhe filloi t'i fuste çantat e Amerit. Ky nuk i po ndihmonte. Vetëm një gjë të vogël, e mori dhe tha: “Kjo është për ty.”

Ameri nuk e hoqi kapelën as kur hynë në automobil. Nuk harroi, megjithatë, që të lidhte rripin e sigurimit dhe ta kujtonte Dinon që ta lidhte po ashtu.

“Alo, o njeri, kjo është Bosnja”, iu përgjigj Dino dhe ndezi motorin.

Në pesë minutat e para të udhëtimit pyesnin njëri-tjetrin për familjet dhe punët, miqtë, Çikagon dhe Visokon, Dino e pyeti Amerin edhe për të birin, ndërsa Ameri i tha Dinon përse tymoste aq shumë dhe mos, ndoshta, ishte pak më i shëndoshë se sa duhej të ishte. Në pesë minutat e tjera, Dino qëllimisht tymoste, ndërsa Ameri sodiste përmes dritares duke mos pushuar së mahnituri me bukuritë e natyrës: “Është e habitshme sesi këta drunj, të zhveshur, gati të thyer prej dëborës, çdo pranverë arrijnë të pulsojnë jetë. Dhe të gjitha kështu të plagosura, sikur shndrisin një jetë të re. Pak kund, kushëriri im, mund të shikosh luftën e pastër të bimëve dhe të kohërave si këtu, ku nga çdo pjesë e tokës mund të lexosh forcën sesi përsëri, zgjohet dhe kryhet fotosinteza. Betoni e ka mbuluar botën. Ndërsa, këtu tek ne bëhet ende luftë fillestare për jetë... Është privilegj të shikosh sesi dukej bota përpara se ta shkatërronim me ndërtime.”

“Qija nënën, nëse gjithmonë e dhjet kaq...”, mendoi Dino, ndërsa u kthye në hyrje të qytetit, duke mos i shikuar drunjat e njomur të ahut të shëmtuar nga degët e zhveshura.

“Të lutem, ndalo”, i tha befasi Ameri, i mallëngjyer.

“Këtu?” - Dino pyeti pak me dyshim.

“Po, po. Të lutem, sa më parë.”

Dino hapi dritaren, hodhi gjysmën e cigares së ndezur dhe u kthye pak nga e djathta.

“Fike motorin”, i tha Ameri duke zgjidhur rripin e sigurisë.

Dino e dëgjoi pa fjalë. Ameri doli me ngut nga Pasati, qëndroi qetë dhe pa nga maja e këpucëve.

”Dhe, hajde tani kur të fillojë të vjellë”, po fliste Dino me vetveten.

Ameri ngriti ngadalë kokën, pa qiellin, me pëllëmbën e djathtë preku anën e majtë të gjoksit dhe u kthye në automobil. Lidhi sërish rripin dhe shikoi Dinon mbushur me një butësi të çuditshme.

“A mundemi tani të shkojmë, do të ikë ditëlindja”, e pyeti Dino.

“Natyrisht. Dhe faleminderit prej teje.”

“Përse?”

“A e ndjeve ti?”

“Çfarë, more?”

“Nuk ndjeve asgjë?!” - Fytyra e Amerit po shprehte çudi.

“Aman, çfarë duhet të ndieja?” - Dinon iu kujtua se ende po qëndronin pranë udhës dhe nisi veturën.

“Do të ta them. Më pret mamaja.”

“E ta qifsha mamin tamam me këtë ndjeshmëri”. Dino ia doli të përmbahej dhe të shante thjesht me vetvete.

E dërgoi Amerin në Mëhallën e Poshtme, i ngjiti çantat, u përshëndet me dajën dhe gruan e tij, ndërsa ata për gati pesë minuta përqafonin të birin, duke ia rrëzuar kapelën m’u në atë pellgun e vogël në hyrje të oborrit, kurse ai vetë sajoi se kishte punë, falënderoi për

ftesën për drekë dhe shkoi në Offside. E gjeti Zhutin tek shikonte rezultatet e ligës braziliane për volejboll femrash.

“Më jep një birrë. Dy”, tha Dino duke hyrë.

“A erdhi Ameri?”, e pyeti Zhuti.

“Jo.”

“Dreqin, pse je sot kaq shumë i mërziur.”

“Nuk është kjo fare asgjë, sesa ti je i mërziqshëm.”

“Në fakt, a erdhi?”

“Jo, kur të them, a më kupton.”

“Pse gënjen?”

“Do të më japësh një birrë apo të shkoj ta blej në dyqan?”

“Ja, njeri, askujt s’i plas.”

“Mua më plas pra”.

Dino piu tetë birra duke u dukur në një mënyrë, sa që Zhutit nuk po i binte më ndërmend ta pyeste për ndonjë gjë tjetër.